



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:118467
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05668455

PPP.nr.25/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në kërkesën e kreditorit F.R. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson av Ekrem Agushi nga Prishtina, për përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj, më datë 10.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET kërkesa e kreditorit F.R., e ushtruar me datë 24.04.2024, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj, nga zgjidhja e lëndës P.nr.17/2022 dhe përjashtohet Përmbauesi Privat M.Sh. nga zgjidhja e lëndës përmbaimore P.nr.17/2022.

A r s y e t i m

Kreditori F.R., me datë 24.04.2024, në këtë gjykatë, përmes të autorizuarit të saj ka dorëzuar kërkesën me shkrim, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj nga zgjidhja dhe procedimi i lëndës përmbaimore P.nr.17/2022, me arsyetimin se në rastin konkret përmbauesi privat me veprimet e tij e ka vënë në dyshim kreditorin se është i ndikuar nga debitori.

Përmbauesi Privat M.Sh., lidhur me kërkesën e kreditorit për përjashtim, ka dhënë deklaratë me shkrim, ku në deklaratën e dhënë me shkrim është pajtuar me kërkesën e kreditorit për përjashtim me arsyetimin se nuk ka më kushte për komunikim dhe trajtim të lëndës.

Gjyqtari individual, duke vepruar sipas nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67 dhe 70, të LPK-së, i shqyrtoj shkaqet dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në kërkesën e tij për përjashtimin e përmbauesit privat M.Sh. dhe pas analizimit të pretendimeve

në kërkesë, vendosi që kërkesën e kreditorit F.R., për përjashtimin e përmbaruesit privat M.Sh., ta pranoj si të bazuar, nga fakti se nga thëniet e kreditorit në kërkesën për përjashtim dhe nga deklaratata me shkrim e dhënë nga përmbaruesi privat, gjykata ka vërtetuar faktin se kreditori e ka humbur besimin e tij tek veprimet procedurale të përmbaruesit privat në këtë rast dhe konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 67, pika g), të LPK-së, që të përjashtohet përmbaruesi privat M.Sh. nga lënda përmbarimore P.nr.17/2022, dhe si rrjedhojë vazhdimi i ndërmarrjes së veprimeve tjera përmbarimore në këtë rast nga përmbaruesi privat M.Sh. në lëndën përmbarimore P.nr.17/2022, vetëm do të shkaktonte humbje edhe më të madhe të besimit të kreditorit tek Përmbaruesi Privat.

Andaj, kjo Gjykatë, duke i marr parasysh të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67, pika g) dhe 70, të LPK-së, e pranoj kërkesën e kreditorit dhe e përjashtoj përmbaruesin privat M.Sh. nga Ferizaj nga zgjidhja e lëndës përmbarimore P.nr.17/2022.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.25/24, më datë 10.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është i lejuar kurrfarë mjetei juridik.